

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI  
i  
Tour Tirana**

**KAPITULLI I**

**Emri, Forma, Selia, Kohezigjatja**

**Neni 1**

**Data e Themelimit dhe Emri**

- 1.1. Sot me date 01.01.2024 themelohet nga ortak/ortaket themelues, sipas legjislationit shqiptar, shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **Tour Tirana** (ne vijim "Shoqeria"), e ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtime "Shpk".
- 1.2. Ortaku/Ortaket i/e Shoqerise ("**Ortaku**" / "**Ortaket**") gezojne pergjegjesi te kufizuar deri ne limitin e kontributit perkates ne kapitalin e shoqerise te perfaqesuar ne kuote/a.
- 1.3. Ne te gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet te leshuara nga Shoqeria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri i saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga :
  - fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" ose "shpk".
  - numri i Identifikimit Personal Tatimor (NIPT) te saj.
  - adresa e regjistruar;
  - pasqyrimi i faktit qe shoqeria eshte ne procedura likuidimi, nese aplikohet.
  - kapitalin e regjistruar dhe te paguar te Shoqerise.

**Neni 2**

**Forma Ligjore**

- 2.1. Shoqeria eshte nje person juridik shqiptar, dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ("shoqeri me pergjegjesi te kufizuar"), ne pajtim me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" ("**Ligji per Shoqerite Tregtare**").

**Neni 3**

**Selia**

- 3.1. Ne momentin e nenshkrimtit te ketij akti, selia e Shoqerise ndodhet ne adresen:
- 3.2 Rruga "Ded Gjo Lul", Pallati 102, Shkalla 8, Nr. 33, Njesia Administrative Nr. 9 (Tiranë)



3.3 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë dege të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 4 Kohezgjatja**

4.1. Kohezgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

### **KAPITULLI II**

#### **Neni 5 Objekti i Shoqërisë**

5.1. Objekti i aktivitetit të Shoqërisë është kryerja e çdo aktivitetit tregtar të lejuar nga legjislativi Shqiptar, dhe veçanërisht:

Operator turistik. Agjensi turistike. Guida Turistike. Organizime udhëtimesh individuale dhe në grup për shtetas shqiptarë dhe të huaj brenda dhe jashtë vendit. Qeradhenie të mjeteve motorrike, bicikletash, motorre elektrike. Organizim eventesh, konferencash, kongresesh, panairesh. Transport kombëtar dhe nderkombëtar mallrash dhe pasagjerësh brenda dhe jashtë vendit. Shitje- blerje dhe dhenie me qera automjeteve, pronash të luajtshme dhe të paluajtshme. Ndermjetesim kundrejt komisionit për pale të treta në fushën e shërbimeve turistike. Menaxhim të pronave të luajtshme dhe të paluajtshme, shitje blerje dhe dhenie me qera. Shërbime konsulence biznesi dhe konsulence në turizëm. Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektivin e mesipërm, që mund të konsiderohet i nevojshëm për ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të shoqërisë.

#### **Neni 6 Ndryshime**

6.1. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë siç parashikohet në këtë Statut.

### **KAPITULLI III Kapitali Themeltar; Quotat e Kapitalit Themeltar**

#### **Neni 7 Kapitali Themeltar**

7.1. Kapitali i Shoqërisë është në total 30.000 (tridhjetëmijë) i zotëruar teresisht në 1 (një) kuota/a (me tej "Kuota"/"Kuotat")



**Neni 8**  
**Ortaku/Ortakët dhe Kuota/Kuotat**

8.1. Në datën e themelimit Shoqëria ka 1 (një) Ortak i cili ka nënshkruar dhe zotëron Kuotat e Shoqërisë, si më poshtë :

- **Z. Gazment Sadiku**, shtetas Shqiptar, i biri i Ismail, lindur në Karice, më 19.09.1976, banues në Rrugë “Dritan Hoxha”, Pallatet Hawai, kulla 1, shkalla 1, ap 4/5 Njesia Administrative Nr. 11, Tiranë – Shqipëri, mbajtës i dokumentit Kartë identiteti me Nr.034716428, Nr.personal H60919063R, me datë lëshimi dt. 03.09.2019, zotëron një kuotë me vlerë të përgjithshme 30.000 (tridhjetëmijë) lekë, që përbën 100 (njëqind) % të kapitalit të Shoqërisë Tour Tirana sh.p.k.;

**Neni 9**  
**Zvogelimi ose Zmadhimi i Kapitalit Themeltar**

9.1. Kapitali mund të zmadhohet ose zvogelohet me vendim të Asamblesë së Ortakeve në përputhje me Kapitullin IV të këtij Statuti, dhe kërkesave të detyrueshme të Ligjit për Shoqëritë.

9.2. Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të kontributeve në para, me anë të kontributeve në natyrë ose me perfshirjen e rezervave (nese ka) dhe fitimit.

9.3 Rritja e kapitalit do të bëhet me lëshimin e kuota të reja apo me rritjen e vlerës së kuotave ekzistuese. Pjesët e reja të kapitalit themeltar do të nënshkruhen dhe vlera e tyre do të paguhet plotësisht.

9.4. Shoqëria nuk mund të blejë asnjë kuotë të saj. Megjithatë me qëllim zvogelimit e kapitalit të Shoqërisë, nëpërmjet vendimit për zvogelimit e kapitalit, Ortaket mund të autorizojnë Administratorin/ret të bëjnë blerjen e kuotave perkatese apo pjesë të tyre dhe ti anulojnë ato.

**Neni 10**  
**Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve**

10.1. Ortaket janë vetëm ata të cilët zotërojnë kuota në Shoqëri.

10.2. Çdo Ortak do të ketë të dehta votë në përjestim me përqindjen e kontributit të zotëruar prej tij në kapitalin e Shoqërisë dhe që përfaqësohet nga Kuota e tij ose pjesë e Kuotës së tij. Çdo Ortak ka të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë, sikunder të drejtat e parashikuara nga ky Statut, dhe dispozitatë ligjore të Ligjit për Shoqëritë.



- 10.3. Ortakut do t'i jepen, pas kerkeses me shkrim, informacione dhe te dhena ne lidhje me aktivitetin e Shoqerise ne cdo kohe, duke perfshire te drejten qe te kontrollojne dokumentat dhe raportet e Shoqerise.
- 10.4. Te drejtat dhe detyrimet qe rezultojne nga zoterimi i Kuotes/tave, transferohen tek cdo zoterues i ri per keto Kuota.
- 10.5. Detyrimet e Shoqerise jane te garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortaku mban pergjegjesi brenda limitit te vleres se Kuotes qe zoteron. Ortaku nuk mban pergjegjesi mbi vleren e investimit te tij ne kapitalin e Shoqerise (pervec garancive dhe huave qe ata leshojne).
- 10.6. Shoqeria nuk mban pergjegjesi per borxhe ose detyrime te tjera te Ortakeve te tij.

#### **KREU IV**

#### **Asambleja e Ortakeve/Ortaku i Vetem**

##### **Neni 11**

##### **Kompetencat**

11.1. Asambleja/Ortaku i Vetem eshte organi vendim marres i Shoqerise i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.

##### **Neni 12**


##### **Mbledhja**

12.1. Asambleja/Ortaku i Vetem duhet te mbledhet te mblidhet te pakten 1 here ne vit.

12. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitetet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkeshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

12.3. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret kur Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, asete te cilat kane nje vlere me te larte se 5% e te gjithe aseteteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara. Asambleja/Ortaku i Vetem do te vendose mbi bazen e raportit te ekspertit kontabel te autorizuar, qe do t'i paraqitet, pervec rastiit kur kjo blerje behet ne burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.

12.4. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret kur Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj propozon te bleje nga ortaku pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% e aseteteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.



12.5. Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 12.3 dhe 12.4, Asambleja/Ortakut te Vetem i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur, pervec rastit kur kjo blesje behet ne burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.

12.6. Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 12.3 dhe 12.4, Asambleja/Ortaku i Vetem mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e Administratoreve.

### **Neni 13** **Menyra e Thirrjes**

13.1. Asambleja/Ortaku i Vetem thirret te vendose per ceshtjet e shtruara perpara tij nepermjet thirrjes se mbledhjeve ose nepermjet konsultave me shkrim.

13.2. Asambleja/Ortaku i Vetem mund te mblidhet nga nje prej Administratoreve ose me iniciativen e tij.

13.3. Asambleja/Ortaku i Vetem mblidhet ne seline e Shoqerise, ose ne ambientet e deges se Shoqerise apo ne cdo qytet, province apo shtet tjetet, siç bihet dakord nga Asambleja/Ortaku. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe rendi i drites perkates i mbledhjeve i njoftohet Ortakut/Ortakeve me poste te regjistruar te pakten 7 dite para mbledhjes, se bashku me dokumentat e nevojshme te lidhura me ceshtjet e rendit te drites. Ne rast se Asambleja/Ortaku i Vetem nuk eshte mbledhur/thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se Asambleja/Ortaku i Vetem eshte dakort.

13.4. Ortaku gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjetet ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.

13.5. Ortaku ka te drejten te votoje ne perputhje me vleren e Kuotes se zoternuar prej tij ne kapital.

13.6. Vendimet e neposhtme do te merren me nje kuorum prej me shume se 1/2 e kapitalit te Shoqerise qe duhet te jete i pranishem ne mbledhje dhe do te miratohen me voten ne favor nga ortaket qe zoterojne te pakten 75% te kapitalit te Shoqerise, i pranishem ne mbledhje:

- vendimet ne lidhje me mos shperndarjen e fitimeve apo/dhe me destinacionin e ndrshem te fitimeve te Shoqerise;
- ndryshimi i Statutit;
- likuidim ose riorganizimin e Shoqerise;
- zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise;



Çdo vendim tjetër do të merret me një kuorum prej me shume se 30% të kapitalit të Shoqërise që duhet të jete i pranishem në mbledhje dhe do të miratohen me votën në favor nga ortakët që zotërojnë 51% të kapitalit të Shoqërise, i pranishëm në mbledhje.

13.7. Ortaku/Ortakët do të njoftohen për përmbajtjen e axhendës së mbledhjes.

13.8. Administratori/ret duhet të mbajne procesverbalet e çdo mbledhjeje të ne përputhje me kërkesat e nenit 90 të Ligjit për Shoqëritë dhe do të regjistrojnë të gjitha vendimet e marra në Regjistrin e Vendimeve.

#### Neni 14

##### Perjashtimi nga e drejta e votes

14.1. Një Ortak përjashtohet nga e drejta e votes në rastin kur është duke vendosur mbi:

- vlerësimin e veprimtarisë së këtij Ortaku.
- shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij.
- ngritjen e një padije kundër tij, nga Shoqëria.
- dhenien ose jo të perfitimeve të reja.

14.2. Kur ky Ortak është i përfaqësuar nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jete në të njëjtin konflikt interesi sikundër Ortaku të cilin përfaqëson.

#### KREU V

##### Administratori/ret


#### Neni 15

##### Administratoreve dhe kompetencat

15.1. Shoqëria mund të administrohet nga një ose më shumë Administrator/re, sipas vendimit të Asamblesë/Ortakut të Vetem. Administratori/ret mund të jete i çdo kombësie dhe nuk është e nevojshme të jete rezident në Shqipëri.

15.2. Në momentin dhe për qëllimin e miratimit të këtij statuti administrator i Shoqërise është:

- **Z. Gazment Sadiku**, shtetas Shqiptar, i biri i Ismail, lindur në Karice, më 19.09.1976, banues në Rrugë "Dritan Hoxha", Pallatet Hawai, kulla 1, shkalla 1, ap 4/5 Njësia Administrative Nr. 11, Tiranë – Shqipëri, mbajtës i dokumentit Kartë identiteti me Nr.034716428, Nr.personal H60919063R, me datë lëshimi dt. 03.09.2019, i cili emërohet për një periudhë prej 5 (pese) vjetësh, nga data e themelimit të Shoqërise, të përcaktuar në këtë dokument. Çdo ndryshim i mëposhëm në lidhje me emërimin e Administratorit/reve nuk do të konsiderohet si një ndryshim Statuti.



15.3. Administratori/ret emerohen per nje periudhe prej 5 (pese) vjetesh, te rinovueshme. Ne rast te me shume se nje Administratori kompetencat qe do te ushtrohen vecmas nga secili prej Administratoreve, nese ky eshte rasti, do te percaktohen ne vendimin e Asamblese/Ortakut te Vetem qe emeton Administratoret.

15.4. Menjehere pas pranimit te emerimit te tij/tyre, Administratori(et) njohin ne se mardhenia e tyre me Shoqerine ndertohet mbi baza mirebesimi; lidhur me kete vendimi per heqjen e tyre nepermjet nje vendimi te Asamblese/Ortakut i Vetem gjykohet si arsye e ligshme per shkarkimin e tyre nga puna, ne perputhje me ligjet perkatese.

15.5. Asambleja/Ortakut i Vetem ka te drejte te shkarkoje Administratorin(ret) ne cdo moment.

15.6. Nese Administratoret e Shoqerise nuk arrijne te bien ne nje mendim te perbashket lidhur me mbylljen, perfundimin ose ndryshimin e transaksioneve, kontratave apo veprimeve te tjera, çeshtja do te referohet tek Asambleja/Ortakut i Vetem.

15.7. Per aq sa eshte e lejueshme dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ose me cdo legjislacion ku aktet e Administratorit(eve) kane fuqi vepruese, Administratori(et) kane te drejten te marrin vendime ne lidhje me detyrat e tyre pa qene fizikisht present ne Shqiperi ose ne ambientet e Shoqerise. Shoqeria mund t'u rimbursoje Administratorit(eve) shpenzimet e arsyeshme gjate udhetimeve lidhur me prezencen e detyrueshme te Administratorit(eve) shpenzimet e vende qe nuk jane brenda qytetit te residences se Administratorit(eve).

## Neni 16

### **Kompetencat dhe detyrimet e Administratorit/reve**

16.1. Kompetencat e Administratorit ne kuader te perfaqesimit te Shoqerise perfshijne:

- (i) kerkesa/thirrjeja e mbledhjes se Asamblese/ Ortakut te Vetem, ne rastet e specifikuara ne nenin 13;
- (ii) menaxhimin e aktivitetit te perditshem tregtar te Shoqerise nepermjet implementimit te politikave dhe planeve te percaktuara nga Asambleja/Ortakut i Vetem;
- (iii) perfaqesimin e Shoqerise me palet e treta;
- (iv) kujdesin per mbajtjen ne menyre te pershtatshme te dokumentave dhe librave kontabel te Shoqerise;
- (v) pergatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit te konsoliduar dhe raportit te ecures se veprimtarise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve qe i paraqiten per miratim tek Asambleja/Ortakut i Vetem;



kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e Shoqerise prane Qendres Kombetare e Biznesit, kur eshte e nevojshme;

(vi) raportimin perpara Asamblese/Ortakut te Vetem, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise;

(vii) kryerjen e detyrave te tjera te caktuara ne ligj dhe nga Asambleja/Ortaku i Vetem.

16.2. Administratori(et) mbikqyrin dhe sigurojne qe zyrtaret, agjentet, te punesuarit, auditoret dhe keshilltaret e Shoqerise te veprojne me kujdesin e duhur dhe te mbrojne sa me mire interesat e Shoqerise. Administratori(et) duhet te raportojne tek Ortaku ne lidhje me personat te cilet emerohen nga Ortaku.

## Neni 17

### Detyrimi i besnikerise dhe pergjegjesia

17.1. Perverç sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14,15,16,17 e 18 te Ligjit te Shoqerive, administratoret detyrohen:

(i) te kryejne detyrat e tyre e percaktuara ne ligj ose ne kete Statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se Shoqerise ne mjedis;

(ii) te ushtrojne kompetencat qe u njihen me ligj ose nga ky statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

(iii) te vleresojne me pergjegjesi ceshjet per te cilat merret vendim;

(iv) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqerise;

(v) te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem

17.2. Administratoret pergjigjen kundrejt shoqerise per cdo veprim apo mosveprim, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprim apo mosveprim eshte kryer ne mirebesim.

17.3. Ne rast te shkeljes se detyres dhe standarteve profesionale, sipas pikave 18.1 dhe 18.2 te ketij neni, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje Shoqerise cdo fitim personal qe ka realizuar gjate kryerjes se ketyre veprimeve te parregullta. Ai ka barren e proves per te vertetuar se kryen detyrat e tij ne rregull dhe sipas standarteve. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje Administrator ata pergjigjen ndaj Shoqerise ne menyre solidare.





17.4. Ne vecanti, Administratori eshte i detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet, neqftese ne kundershim me Ligjin per Shoqerite kryen veprimet e meposhtme:

- (i) i kthen Ortakeve kontributet;
- (ii) i paguan Ortakeve interesa apo dividente;
- (iii) i shperndan asetet Shoqerise;
- (iv) lejon qe Shoqeria te vazhdoje aktivitein e saj, kur duhet ta kishte parashikuuar qe kjo e fundit nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet e saj;
- (v) jep hua;

**KREU VI**  
**Administrimi Financiar i Shoqerise**

**Neni 18**  
**Eksperti Kontabel i Autorizuar**

18.1 Ortaku cakton ekspertin kontabel te autorizuar (auditues) per te dhene sherbimet e tij kudrejt Shoqerise.

18.2. Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

**KREU VII**  
**Aktiviteti Shoqerise**


**Neni 19**  
**Viti ekonomik-financiar**

19.1. Viti ekonomik-financiar fillon ne ditën e pare te muajit Janar dhe perfundon ne ditën e 31-t te muajit Dhjetor te seclit vit. Viti i pare financiar nis ne datën e themelimit te Shoqerise.

**Neni 20**  
**Mbajtja e Llogarive**

20.1. Shoqeria do te mbaje llogarite ne leke dhe ne monedhe te huaj.

**Neni 21**  
**Llogaritja dhe Shperndarja e Fitimit**



21.1. Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te pasqyrave financiare te aprovuar nga Asambleja/Ortaku i Vetem. Cdo ndryshim ne destinacionin e fitimit do te caktohet nga Asambleja/Ortaku i Vetem ne perputhje me Statutin dhe me ligjet e zbatueshme.

21.2. Ne baze te Ligjit per Shoqerite, Shoqeria mund te shperndaje fitimin tek Ortaket vetem nese pas kesaj shperndarje:

- (i) asetet e Shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e kesaj te fundit;
- (ii) Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve te ardhshem;
- 21.3. Administratoret leshojne nje certifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e pikes 22.2 me siper. Ndersa kur gjendja e Shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush kerkesat sipas 21.2, Administratoret nuk mund ta leshojne kete certifikate.
- 21.4. Administratoret pergjigjen ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.

## **KREU VIII** **Modifikimi i Formes Ligjore dhe Prishja**

### **Neni 22** **Modifikimi i Formes Ligjore**

22.1. Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese/Ortakut te Vetem ne perputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.

22.2. Shoqeria do te permbushe te gjitha procedurat ligjore te regjistrimit te nevojshme ne Shqiperi per kete qellim.

### **Neni 23** **Prishja e Shoqerise**

23.1. Shoqeria mund te prishet ne rrethanat e meposhtme:

- (i) si pasoje e perfundimit te kohezgjatjes per te cilin ishte themeluar;
- (ii) me vendim te Asamblese/Ortakut te Vetem;
- (iii) me hapjen e nje procedure falimentimi;
- (iv) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarse ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";



- (v) me vendim gjykate;
  - (vi) per arsye te tjera te parashikuara nga Asambleja/Ortaku i Vetem ne cdo kohe.
- 23.2. Administratori(et) regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”. Ne rast se prishja e Shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ia njoftimin vendimin kesaj te fundit per regjistrim.

**KREU IX**  
**Te ndryshme**

**Neni 24**  
**Largimi i Ortakut**

24.1. Largimi dhe perjashtimi i nje Ortaku, si dhe pasojat qe kjo sjell, do te rregullohen nga dispozitat nr. 101, 102, 103 te Ligjit per Shoqerite Tregtare.

**Neni 25**  
**Te tjera**

25.1. Cdo ceshtje tjeter, e cila nuk eshte peremundur ne kete statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite.

**Ortaku i Shoqerise**

**Tour Tirana SHPK**

**Z. Gazment Sadiku**

*Gazment Sadiku*

